



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, më 5 qershor 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Jehona” sh.p.k, me NIPT: K86810001U, për subjektin audio privat vendor “Radio Jehona”, me zonë ofrim shërbimi “*Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës*”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendimi nr. 42, datë 05.06.2023).**
2. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Elida Llupa, me NIPT: L81419038G, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet “Elrodi TV”, me zonë ofrim shërbimi “*Tiranë*”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendimi nr. 43, datë 05.06.2023).**
3. Zëvendësimin e licencës për transmetime analoge me licencë shërbimi programi audioviziv të shoqërisë “Televizioni Kukësi” sh.a., me NIPT K48021203K, për subjektin audioviziv “Tv Kukësi”, për qarkun Kukës. **(Vendimi nr. 44, datë 05.06.2023).**
4. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “IRLA” sh.p.k., me NIPT K32515025A, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor IRLA”, me zonë ofrimi shërbimi “*Njësitë administrative Berat*”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendimi nr. 45, datë 05.06.2023).**
5. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “FABBTEL” sh.p.k., me NIPT: K29824103U, me z. Hilmi Xhahysa administrator dhe ortak me 50% kuotave dhe z. Gëzim Çerri ortak me 50% të kuotave, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Fabbtel”. **(Vendimi nr. 46, datë 05.06.2023).**

6. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 98, datë 07.06.2017 të AMA-s “Për miratimin e Numrit Logjik të Programit të shërbimeve programore kombëtare të përgjithshme dhe shërbimeve programore private rajonale/lokale”, të ndryshuar me vendimet nr. 197 dhe nr. 198, datë 25.10.2017 të AMA-s, sipas Shtojcës nr. 1. **(Vendimi nr. 47, datë 05.06.2023).**
7. Vendosjen e sanksionit me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj shoqërisë “Abc News” sh.a, pajisur me licencë shërbimi për subjektin audioviziv privat “Abc News”, për shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, gjatë transmetimit të emisionit “Zonë e Lirë”, të datës 12 maj 2023. **(Vendimi nr. 48, datë 05.06.2023).**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 5 qershor 2023